



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 52, datë 27.03.2019

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR
VENDIMEVE TË KRYEINSPEKTORIT TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
PËR ARKIVIMIN E ANKESËS OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar nenet 147/1, 147/a, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, pasi shqyrtoi “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari“, të ngritur me vendimin nr. 31, datë 14.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari“, sipas tekstit bashkëlidhur të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR

KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR